



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1418, datë 08.10.2010

Për

“Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Altelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 1368, datë 28.08.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e ankimeve administrative të Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve – ZMK, Shoqata e Operatorëve Alternativë, 7 Operatorëve Alternativë, Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a dhe Altelecom sh.a në lidhje me aktin administrativ Vendimi nr. 1348 datë 26.07.2010 të AKEP për “Përcakimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse ”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 08.10.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Altelecom sh.a në lidhje me VKD nr. 1368, datë 28.08.2010 të AKEP “Për shqyrtimin e ankimeve administrative të Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve –ZMK, Shoqata e Operatorëve Alternativë, 7 Operatorëve Alternativë, Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a dhe Altelecom sh.a në lidhje VKD nr. 1348 datë 26.07.2010 të AKEP për “Përcakimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*K.Pr.A*)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (*Rregullorja e Brendshme*);
4. “Rregullore për analizën e tregut”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues nr. 747, date 17.07.2009 (*Rregullorja*);
5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (*Rregullorja*);
6. Vendimi 1348, date 27.08.2010 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcakimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse” (*Vendimi nr. 1348*)
7. Vendimi nr. 1368, datë 28.08.2010 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e ankimeve administrative të Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve –ZMK, Shoqata e Operatorëve Alternativë, 7 Operatorëve Alternativë, Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a në lidhje VKD nr. 1348 datë 26.07.2010 të AKEP për “Përcakimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse ” (*Vendimi nr. 1368*),

K Ë SH I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 4038/1 prot, datë 08.09.2010 e Albtelecom sh.a (AKEP nr. 2838/11 prot, datë 08.09.2010) “Ankimi Administrativ”, (*Ankim Administrativë*);
2. Vendimi nr. 1368, datë 28.08.2010 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e ankimeve administrative të Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve–ZMK, Shoqata e Operatorëve Alternativë, 7 Operatorëve Alternativë, Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a” (*Vendimi nr. 1368*);
3. Vendimi 1348, date 27.08.2010 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcakimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse” (*Vendimi nr. 1348*)
4. Projektvendim i KD te AKEP për Shqyrtimin e ankimit administrativë të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 1368, datë 28.08.2010 të Këshillit

Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e ankimeve administrative të Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve–ZMK, Shoqata e Operatorëve Alternativë, 7 Operatorëve Alternativë, Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a” (**Projektvendimi**);

5. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);

si dhe,

6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Albtelecom me shkresën nr. 4038/1 datë 08.09.2010 (AKEP nr. 2838/11 prot, datë 08.09.2010) brënda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 140 të ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativë për shfuqizimin e Aktit Administrativ Vendimi nr. 1368, datë 28.08.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e ankimeve administrative të Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve–ZMK, Shoqata e Operatorëve Alternativë, 7 Operatorëve Alternativë, Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a”;
2. Albtelecom sh.a nëpërmjet Ankimit administrativë kërkon shfuqizimin e Vendimit nr.1368, datë 28.08.2010 të AKEP, për sa i perket ndryshimit të disa tarifave të shërbimeve të pakicës objekt rregullimi nga AKEP të miratuara me VKD nr. 1348, datë 26.07.2010 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a, me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”;
3. Albtelecom konsideron se, nuk është vënë në dijeni në lidhje me ankimin administrativ ndaj vendimit nr. 1348 datë 26.07.2010 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse” dhe se as nuk është njoftuar për të marrë pjesë në shqyrtimin e ankimit.
4. Albtelecom pretendon se, në zbatim të dispozitave ligjore të vendimit nr. 1348 datë 26.07.2010 të AKEP, de facto kishte filluar aplikimin e tarifave të reja, duke i publikuar këto ndryshime në media si dhe në sistemet e billing-ut;
5. Albtelecom parashtron se, është njohur me vendimin nr. 1368 datë 28.08.2010 vetëm me datë 30.08.2010, dhe Albtelecom është gjendur para pamundësisë praktike për të zbatuar ndryshimet e paraqitura në vendimin nr. 1368 datë 28.08.2010;
6. Në vijim Albtelecom sqaron se ndryshimet e përcaktuara në vendimin nr. 1368 datë 28.08.2010 sjellin pasoja përkeqsuese për Albtelecom në 2 drejtime:
 - a) *Ulja e tarifave të bisedave telefonike për pajtimtarët familjarë dhe biznesin*, shoqërohet me ulje të të ardhurave për këtë kategori thirrjesh duke sjell vështirësi të Albtelecom për të mbuluar kostot e shërbimeve të veta, si dhe për të nxjrrë një fitim të arsyeshëm;
 - b) *Rritja e tarifave për kategorinë “Të tjerë” për pajtimin mujor dhe thirrjeve telefonike kombëtare drejt rrjeteve celulare* e përball Albtelecom me një situatë që kërkesa e këtyre shërbimeve në rast të aplikimit të tarifave të reja e përballë Albtelecom në një situatë të tillë që kërkesa e këtyre shërbimeve me aplikimin e tarifave të reja do të bjerë në mënyrë të shpejtë pasi ekzistojnë në treg alternativa më kompetitive, gjë e cila do

të shoqërohet me rënien e mëtejshme të të ardhurave të Altelecom. Gjithashtu një aplikim i tillë do të shkonte në kundërshtim me principin e ribalancimit të tarifave;

7. Altelecom duke i'u referuar praktikave në vendet ku ka ekzistuar apo ekziston deficieti i aksesit, operatorit mbi të cilin rëndon ky deficiet, edhe në kushte më të favorshme se Altelecom i është lejuar të rekuperojë këtë deficiet nëpërmjet:
 - a) Ofrimit të shërbimeve të tranzitimit për terminimin në rrjetet e telefonisë së lëvizshme;
 - b) Terminimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare hyrëse;
 - c) Shitja tek klientët shqiptarë e thirrjeve telefonike ndërkombëtare dalëse;
 - d) Ofrimi i bisedave kombëtare të pajtimtarët e vet;
 - e) Terminimi i bisedave telefonike që përcillen nga operatorët e tjerë shqiptarë;
8. Për sa më sipër Altelecom konsideron se niveli aktual i tarifave në treg dhe gjëndja e konkurrencës në të, nuk e lejon Altelecom të rekuperojë pjesën më të madhe të këtij deficieti në asnjërin nga drejtimet e mësipërme;
9. Altelecom vlerëson faktin se AKEP në parashtrimet e vendimit nr. 1368 date 28.08.2010 i ka pranuar vështirësitë e Altelecom.
10. Për sa më sipër Altelecom nëpërmjet këtij ankimimi administrativ kërkon pezullimin e zbatimit të aktit administrativ Vendimit nr. 1368 date 28.08.2010 të AKEP, si dhe pranimin ankimit administrativ dhe shfuqizimin e aktit administrativ objekt ankimi siaps kërkesës së Altelecom sh.a;
11. Ankimimi administrativ në lidhje me VKD nr.1368, date 28.07.2010, pezullon efektet e tij, nga data e depozitimit të ankimit në AKEP deri në marrjen e një vendimi përfundimtar të AKEP mbi ankimimin administrativë;
12. AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrativë, në lidhje me Vendimin nr. 1368, datë 28.08.2010 të AKEP, gjykon se:
 - Ndryshimi i tarifave të cituara në pikën 3 të VKD nr.1368, date 28.07.2010, është arsyetuar nga AKEP dhe është bërë me qëllimin e realizimit të objektivave rregullatore të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, dhe njëkohësisht me qëllim kompensimin e Altelecom për reduktimin e imponuar të tarifave lokale, ka lejuar Altelecom të rrisë tarifën e pajtimit mujor dhe thirrjeve drejt rrjeteve celulare për pajtimtarët e kategorisë Të tjerë. Këto ndryshime janë gjykuar si të arsyeshme duke marrë në konsideratë karakteristikat e pajtimtarëve Familjare dhe Të tjerë.
 - Ndryshimet e imponuara nga AKEP janë minimale dhe prekin vetëm 3 zëra. Reduktimi i tarifave të thirrjeve lokale mund të aplikohet nga Altelecom edhe pa publikim të reduktimit të tyre, pasi këtë gjë e lejon edhe kontrata e re e pajtimtarit. Gjithashtu, bazuar në përcaktimet e Termave të Përgjithshme të Kontratave (Kontrata Tip), të miratuara nga AKEP me vendimin nr.1330, date 15.07.2010, ndryshimet e tarifave të miratuara nga AKEP hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar nga AKEP. Gjithashtu AKEP gjykon se Altelecom ka kapacitetet teknike për të implementuar ndryshimet e tarifave brnda një kohe të shkurtër në sistemin e vet të billingut. Nderkohë nëse Altelecom ka shqetësim për humbje të klientëve Të tjerë, për shkak të rritjes së tarifës, theksojmë se tarifat e miratuara janë vetëm niveli

maksimal dhe Albtelecom është i lirë ta aplikojë tarifa më të ulëta. Njëkohësisht vihet re se ky shqetesim i Albtelecom nuk shfaqet për humbje të abonentëve Familjarë, nga rritja e tarifave të lejuara me VKD 1348, date 23.07.2010.

- Ndryshimet e imponuara, si edhe tarifat e tjera me pakicë dhe me shumicë të Albtelecom janë të përkohshme, deri në ribalancimin e plotë të tarifave të Albtelecom, që siç është theksuar disaherë nga AKEP, do të kryhet sipas përcaktimeve të një vendimi të veçantë të AKEP, që do të merret pas një proçsi konsultimi publik me palët e interesuara ne muajt në vijim.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 4038/1 datë 08.09.2010 të Albtelecom sh.a. në lidhje me vendimin nr.1368, datë 28.08.2010.
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**